[Shqiptarja.com]

E enjte 18 Gusht 2022 - Përditësimi i fundit 12:46

Flash Burime: Mbi 2 pakot me kanabis të ardhura nga anglia ishin shënuar emrat 'Ardit Brahaj' e 'Armir Cena'

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1



Sherri për kalin në 2019, Shpati Lena dhe Hakim Xhezo që u vranë sot, shoku dhe vëllai i Eduart Xhezos! Ekzekutoi 'Arbenin e Çeçesë' se i rrahu rojen

2

VIDEO e arrestimit/ Sot u ekzekutua në Vlorë, Shpati Lena u prangos 5 muaj më parë por u lirua më pas gjykata

3



Atentat në autostradën Fier-Vlorë, vriten me breshëri kallashnikovi në makinë Shpati Lena dhe Hakim Xhezo! 3 autorë të dyshuar, shkak dyshohet hakmarrja (VIDEO)

4



E mbuluar nga gjaku dhe e bërë shoshë nga plumbat, Report Tv siguron pamjet e makinës së viktimave në Vlorë (VIDEO)

5

Atentat me 2 të vrarë në Vlorë, dalin pamjet nga vendi i ngjarjes! Trupat e viktimave ende në makinë

Kronikë

Parandalohet atentati në Shëngjin! Kapet 'ushtari' i Ervis Martinajt me kallashnikov në makinën e blinduar me xhama të zinj

Nikoll Sherrniku, i njohur si ushtar i Brilant Martinajt, u arrestua në Kune të Lezhës me dyshimin e policisë se ishte bërë gati për të kryer një atentat, por shënjestra e mundshme ende nuk dihet. Brenda një makine të blindur me xhama të zinj, u arrestua edhe shoferja, mike e tij, që tentoi të fshehë kallashnikovin. ***Kapen në Toyotën e blinduar dhe me xhama të zinj, e mbushur me municione dhe një kallashnikov***

■ Hakmarrje për atentatin e Fushë-Krujës? Më kallashnikovin me plumbin gati në fole, lidhja mes të arrestuarit sot dhe vrasjes së 3 njerëzve të Ervis Martinajt

[Sh].com **Redaksia**
17 Gusht, 13:10 | **Përditesimi i fundit: 17 Gusht, 16:20**

LEZHË- Një ngjarje kriminale, që siç duket nga rrethanat e organizimit dyshohet për një vrasje apo atentat, është parandaluar nga policia e Lezhës ditën e sotme në Kune në Shëngjin. Në pranga ka rënë 28-vjeçari, Nikoll Sherrniku, një emër i njohur për efektivët, pasi ishte nën masën 'arrest shtëpie', sepse ishte i implikuar në vrasjen e ***efektivit Xhulio Prela*** në dhjetor të vitit 2020. Në makinën e blinduar tip 'Toyota' u kap dhe u arrestua edhe 34-vjeçarja Flutura Berisha, ndërsa brenda mjetit ishte edhe një 15-vjeçar.

Ky parandalim i këtij atentati, vjen pas një sërë ngjarjesh kriminale në qarkun e Lezhës, ende të pazbuluara, ku dyshohet se janë ekzekutuar anëtarë të bandës së Ervis Martinajt. Nikoll Sherrniku, dyshohet si i përfshirë në grupin e Ervis Martinajt, ndërsa ishte edhe shok i Brilant Martinajt, i cili u vra në atentatin e mbikalimit të Fushë Krujës. Megjithatë ende nuk është konfirmuar, nëse ngjarja kriminale e dyshuar se do te ndodhte, pasi u parandalua nga policia, mund të ishte nje hakmarrje, pas atentateteve të mëparshme.



LEXO EDHE:
Përfundon raundi i parë i takimit trepalësh për dialogun Kosovë-Serbi, vazhdojnë takimet ndaras me BE-në

Policia e Lezhës ka vëzhguar automjetin e blinduar tip 'Toyota', i cili ishte parkuar në afërsi të një pallati në zonën e Kunes në Shëngjin dhe më pas kanë ndërhyrë për të neutralizuar personat që ndodheshin në to. Sapo kanë parë policinë duke u afruar, Nikoll Sherrniku dhe Flutura Berisha, bashke me 15-vjeçarin e mitur, kanë dalë menjëherë nga automjeti dhe kanë tentuar të largohen me vrap.

Gjatë tentativës për t'u larguar, 34-vjeçarja Flutura Berisha, e cila ishte edhe drejtuesja e 'Toyotës', ka tentuar njëkohësisht që të fshehë edhe një armë zjarri, në afërsi të vendit ku automjeti ishte i parkuar. Arma e zjarrit kallashnikov, së bashku me krehër e me fishek në fole, është gjetur më pas nga policia.

Policia ka kryer kontroll brenda makinës me të cilën po lëvizte Flutura Berisha dhe Nikol Sherniku, ku ka gjetur një krehër automatiku me fishekë në të. Sakaq gjatë kontrollit të ushtruar në çantën e dorës së 34-vjeçares, janë gjetur 2 radio marrëse - dhënëse, si ato të policisë.

Nikoll Sherrnikun, 28 vjeç, banues në Kurbin, u arrestua për veprat penale "Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyese dhe municionit" dhe "Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit" dhe Flutura Berishën, 34 vjeçe, banuese në Kurbin, u arrestua për veprat penale "Moskallëzimi i krimit" dhe "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës". Policia thotë se bazuar në hetimet e deritanishme lindin dyshime se lëvizja e këtyre shtetasve me automjetin e blinduar, në role të ndryshme, ishte për të realizuar një ngjarje kriminale.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 14:17

Hakmarrje për atentatin e Fushë-Krujës? Më kallashnikovin me plumbin gati në fole, lidhja mes të arrestuarit sot dhe vrasjes së 3 njerëzve të Ervis Martinajt



Nikoll Sherrniku, 28-vjeç, i arrestuar sot nga policia e Lezhës gati të kryente një atentat sipas të gjitha gjasave ka një lidhje me ngjarjen e rëndë të ndodhur disa javë më parë kur u vranë 3 vetë në Fushë-Krujë.

Sherrniku është i akuzuar si i përfshirë në vrasjen e ish-efektivit Xhuliano Prela dhe shok i Brilant Martinajt, i cili u vra në atentatin e mbikalimit të Fushë Krujës. Madje edhe Martinaj ka qenë i akuzuar më parë për vrasjen e ish-efektivit.

Nuk dihet nëse Nikoll Sherrniku ishte gati të kryente ndonjë atentat si hakmarrje në lidhje me eliminimin e shumë prej njerëzve të Ervis Martinajt kohëve të fundit apo jo. Por siç duket përplasje mes bandave në këtë zonë të Shqipërisë vijon.

Brilant Martinaj, Diklen Vata e Besmir Hoxha ***u qëlluan me rreth 60 plumba kallashnikovi*** mesditën e 17 korrikut në makinën Volkswagen Passat, me të cilën po lëviznin drejt Laçit. Nga breshëria e plumbave makina mori flakë dhe për pasojë prej tyre u shkrumbuan. Vetëm Vata mundi të dalë nga makina, por agresorët u rikthyen sërish dhe u siguruan të vdiste.

M.Q./K.T./Shqiptarja.com

TAG: flutura berisha nikoll sherrniku Lezhe Shengjin

Komento

Komente

Nikola: 17/08/2022 22:03
Sa per info vertet sta mbush synin ky zhulsi me arme e me blind Por ka qene krahu djathte i ktyre zhulsave dhe ka trasheguar shume makina e lek sepse ato i lenin ktyre makina e prona ne emer Per shperndarje pasurie nuk i mbanin te gjitha vete Pervec motrave e vellezer e kushuri, i kane lene shume ktyre mallistave Dhe ne nje forme a nje tjeter kto duhet ti justifikojne.. Keshtu qe sa te shuhen keqbersit e fundit sepse te gjithe nje ftyre kane.. Keshtu do vazhdoje shqiperia. Ka pase dhe raste kur i kane gezuar leket e pronat Dhe sjane ndjere si ne shume raste te olldashi e kosta trebicka e gerdeci e kromi dhe shume variane droge e trafiqesh dhe te Santo i bankes qe kane pase miliona euro per te kthyer por qe su kthyen kurre..
Përgjigju

> **Per nikola:** 17/08/2022 23:51
> Shyqyr qe the Kromi, kush po e gezon kromin fol pak dge per ate sa per info !! Meqe qeke spiun i sakte me info kusho esht nona e kromit dhe krime tjera .....

Toyota: 17/08/2022 21:50
Kjo toyota eshte pare neper tirane pardje, bulevard pallati kongreseve stadium qemal stafa dhe libri universitar 2-3 here xhiro Bashke me ate vajzen ne timon dhe ka blere cigare te kto kjoskat.
Përgjigju

Po krahun tjeter e kap policia: 17/08/2022 17:47
Krahu tjeter i Dukajve, Doqeve, Dokleve etj etje etj nuk i prek kush dhe kur vrasin 3 vet mes dites e ndonjehere mes kryeqytetit. Apo policia e ka kuptuar qe Martinaj eshte ngushte e duhet te dorezohet/pendohet po do te shpetoj jeten.
Përgjigju

> **Krahu leshit..:** 17/08/2022 21:54
> Krahun tjeter e ka prek zoti skane nevoje ta prekin tjeret! Te gjithe ne kerkim dhe te gjithe ruhen si ne bunker Skane shanse as me dal ne dritare, as ne kafe, Dmth i rrofshin leket e fama, se jete qeni.. Te mendosh dhe pas gjithe ktyre sakificave e durimi dhe me siklete e vuajtje prap egziston mundesia te rikthehen ne burg! Bota portokall..

Ilir: 17/08/2022 17:37
Q…. rrobte , me te vra ky lloj pabuksi . Nikolla ka thirr vete me shku ne burg pa e gjet ata “ shoket “ hahahahaha .
Përgjigju

Beni: 17/08/2022 16:46
Kot e arestuat, e kishit len te lire ta gjenin ato shoket e tjer qe po e kerkojne
Përgjigju

Lezhjani: 17/08/2022 16:36
Ka mbet me marr hak ky ahahahah. Per fat te keq ngjarjet e fundit do te sjellin ngjarje te tjera te renda. Visi eshte terhequr mu organizu.
Përgjigju

Alban: 17/08/2022 15:25
Funderrine e qelbur.Si i lene te lire keta kafshe?
Përgjigju

Lacjan: 17/08/2022 15:04
Kane mbete punet e vrasjes te Nikolla, tan diten i drogum e pijshem rrin. Nuk nigjon kush me u marre ma me Martinajt se ja shohim sherrin
Përgjigju

shoku: 17/08/2022 14:47
Lutu zotit qe te gjeti shteti se po te prisnin ata te tjeret qe u dogjen je me fat.
Përgjigju

Xhulio Prela: 17/08/2022 14:19
E vrate djalin e ri per hic gje dhe ju zuri mallkimi i babait te tij te ndershem. Zoti eshte i madh. Ju jeni funderrinat e shoqerise bashke me sistemin gjygjesor qe ju le te shijoni lirine
Përgjigju

Shkodra: 17/08/2022 13:34
Ky duhet te ishte ne burg per vrasjen e xhulios ju gjet pistoleta ne shpin e tij . Ky tu u pergadit me ba vrasjen tjeter . Tesh te pakten denone sa esht ligji per armembajtje pa leje
Përgjigju

Ca behet ketu: 17/08/2022 13:31
Ne arrest shpie dhe del me ket makin te blinduar me xhama te zinj !! A ka polici ne ket vend ??? Gjith ket makin me ter xhamat e zi nuk e shikojn ne rrug ???? Po ai gjykates qe e ka liru ket kriminel ne arrest shpije ??
Përgjigju

> **Partia:** 17/08/2022 17:29
> Këto ndodhin në të gjithë botën, bëjnë dhe filma dhe sidomos fajin e ka Saliu

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Thirrjet për kursimin e energjisë elektrike, mendoni se zbusin pasojat e krizës energjetike?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Politikë

'Partia e Lirisë' reagon për atentatin në Vlorë: Rama vuri qeverinë në funksion të krimit të organizuar! Policia e Shtetit vetë numëron viktimat
18 Gusht, 12:38

Sociale

Shkurtohet praktika për mësuesit nga 1 vit në 3 muaj, Ministrja e Arsimit: Punësim më i shpejtë!
18 Gusht, 12:36

Kronikë

E mbuluar nga gjaku dhe e bërë shoshë nga plumbat, Report Tv siguron pamjet e makinës së viktimave në Vlorë (VIDEO)
18 Gusht, 12:32

Politikë

Atentati në Vlorë, Agalliu: Qyteti bregdetar, vend ku krimi i organizuar kryen vrasje në mes të ditës
18 Gusht, 12:22

Opinion

Plator Nesturi: Berisha në kërkim të taborreve të humbura elektorale
Plator Nesturi
18 Gusht, 12:21

Politikë

Berisha takim me fermerët: Hapja e doganave në kuadër të Ballkanit të Hapur do falimentojë fermat tona
18 Gusht, 12:20

Kronikë

U vra 33-vjeçari në mes të bulevardit në Elbasan, mësohen emrat e autorit dhe personave të tjerë të përfshirë
18 Gusht, 12:09

Kronikë

U vranë sot, viktimat lëviznin me makinë të blinduar! Autorët i pikasën sapo ndërruan automjet
18 Gusht, 12:07

Politikë

Atentati me 2 të vrarë në Vlorë, Alibeaj: Ngjarja dëshmon se shteti është dorëzuar përballë krimit
18 Gusht, 12:05

Sport

Performancat mbreslënëse s'kanë të ndalur, Gega kualifikohet në finalen e kampionatit europian
18 Gusht, 12:01

Kronikë

Kush është i arrestuari për vrasjen e 33-vjeçarit në Elbasan (EMRI)
18 Gusht, 11:51

Kosova & Rajoni

Nis takimi Kurti - Vuçiç në Bruksel, Borrell: Tensionet në veri dëshmojnë nevojën për normalizimin të plotë
18 Gusht, 11:42

Lajmi i fundit

Përfundon raundi i parë i takimit trepalësh për dialogun Kosovë-Serbi, vazhdojnë takimet ndaras me BE-në
18 Gusht, 12:41

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje